



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.04.2016 mori:

### V E N D I M

- I. **Ekziston konflikti i interesit** në rastin me nr. AKK -03-02-4309/15, për z. Sylë Dervishaj – Anëtar i Kuvendit Komunal në Skënderaj dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat.
- II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.
- III. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.
- IV. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

### A r s y e t i m

I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, neni 18 (paragrafi 1 dhe 3), si dhe në bazë të vendimit Nr. 03-02-4309/15, është hapur rasti nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi për zyrtarin e lartë, z. Sylë Dervishaj, Anëtar i Kuvendit Komunal në Skënderaj dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.P “Eko – Kom”.

Zyrtari i lartë, është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (AKK-DPK-01-4564/15), pas pranimit të kësaj shkrese, kemi njoftuar zyrtarin e lartë për kufizimin e përcaktuar në Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit Nr.04/L-051, konkretisht neni (15 paragrafi 1), në të cilën shprehimisht thuhet:



*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private”.*

Po ashtu, neni 16 (paragrafi 3), të Ligjit nr. 04/L-051, përcakton se zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit nuk ka pranuar ndonjë informatë nga z. Dervishaj, për shmangien e konfliktit të interesit, konform rekomandimeve që i janë dhënë.

Me datë 05.02.2016, Agjencia i ka bërë shkresën e dytë “njoftimi paralajmërues” (AKK-01-455/16), me të cilën zyrtarit të lartë i është kërkuar që të heq dorë nga funksioni menaxherial në biznes privat, për të shmangur konfliktin e interesit.

Përkundër afatit ligjor të dhënë nga Agjencia zyrtari i lartë z. Dervishaj, nuk ka shmang gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhet.

Në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit neni 14 (paragrafi 1, 2) *“personi, zyrtari i lartë, pronari i aksioneve, gjegjësisht pjesës së kapitalit në një ndërmarrje, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet t’i transferojë të drejtat e administrimit ose menaxhimit, apo drejtimit të ndërmarrjes tek ndonjë person të besuar”.*

*“Personi, zyrtar i lartë, është i obliguar që në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga zgjedhja, vendosja ose emërimi në detyrë me post zyrtar, të bëjë transferimin e të drejtave në udhëheqjen e ndërmarrjes në personin e besuar kurse brenda afatit prej pesë (5) ditë nga data e transferimit së këtyre të drejtave ta njoftoj me shkrim Agjencinë”.*

II. Bazuar në nenin 18 (paragrafi 8) të Ligjit (Nr.04/L-051), në rast se zyrtari i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.

III. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuara në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3.

Sipas nenit 20 pika 2, “Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtari i lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund ti shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit”.

IV. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

